

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 18.03.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, bazuar në shtojcën 15 të Rregullores Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Planin e Punës të MZHR-së për vitin 2025, Rregullore (QRK) Nr. 21/2024 për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Udhëzuesin për Aplikantë nga Thirrja Publike PZHRB 2025 – Masa 4, Nënmasa 4.1 si dhe bazuar në nenin 12 të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave jo-qeveritare në fushën e zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF – Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i MZHR-së, kodi ekonomik 221/në kuadër të programit Subvencione dhe Transfere.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 - 1.1 Teksti i thirrjes publike
 - 1.2 Udhëzimet për aplikantët
 - 1.3 Formularët e aplikimit
 - 1.4 Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 - 1.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1 Forma e përshkrimit të programit apo projektit

- 2.4 Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
- 2.5 Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
- 2.6 Deklarata për Aktivitetet e kontraktori e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 3.1 Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
- 3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
- 3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

- 1. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MZHR-së: <https://mzhr.rks-gov.net/language/sq/>

V.


- 1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, MZHR do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
- 2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
- 3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

- 1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, Udhëheqësi i institucionit do të nxjerr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
- 2. MZHR do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
- 3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal

VII.

- 1. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Besim Kamberaj

Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Zhvillimit Rajonal

Në kopje: Ministrit të MZHR-së
DPKZHR-së
Divizionit për Buxhet dhe Financa